



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri
Mbledhja nr.17
Prishtinë, me 10 nëntor 2008
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P R O C E S V E R B A L
nga mbledhja e Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri

Në mbledhje morën pjesë: Shkumbin Demaliaj, Emrush Xhemajli, Naim Maloku, Zafir Berisha, Eqrem Kryeziu dhe Agim Veliu

Munguan: Bojan Stojanovič, Zulfi Merxha, Gani Geci dhe Melihate Termkolli

Nga zyra mbështetëse mori pjesë: Nur Çeku, Antigona Ibraj.

Mbledhjen e kryesoi:
Rrustem Mustafa, kryetar i Komisionit

Për këtë mbledhje ishte propozuar ky rend ditë:

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Miratimi i procesverbalit të datës 30.10.2008**
- 3. Shqyrtimi i Ligjit për Tubimet Publike**
- 4. Shqyrtimi i Ligjit për Gjendjen Civile**
- 5. Të ndryshme**

Kryesuesi, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës i miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së datës 30.10.2008

Procesverbali i mbledhjes së datës 30.10.2008 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Ligjit për Tubimet Publike

Kryesuesi theksoi, se sipas vendimit të Kuvendit të Kosovës, datë 18 korrik 2008, ky komision është ngarkuar, ta shqyrtoj Ligjin për tubimet publike, i cili është ligj prej 18 ligjeve të pa nënshkuara nga PSSP-ja, që tani janë kthyer në Kuvend për rishqyrtim. Komisioni ka caktuar z.Agim Veliu si referues për këtë ligj. Pra z.Agim Veliu do ta prezantoj raportin me propozim-amendamente.

Agim Veliu tha, ne kemi mbajtur disa takime me përfaqësuesit e MPB-së, për të shqyrtuar këtë ligj dhe në si grup punues i kemi nxjerr këto amendamente dhe i propozojmë komisionit që këto propozim-amendamente të aprovohen sot.

Komisioni pastaj shqyrtoi dhe aprovoi një nga një 22 propozim-amendamentet.

Kryesuesi konstatoi, se raporti me këto amendamente të miratuara për Ligjin për Tubimet Publike, të procedohet për miratim në seancë plenare.

4. Shqyrtimi i Ligjit për Gjendjen Civile

Kryesuesi theksoi, se për këtë ligj grupi punues prej tre anëtarëve të komisionit i kryesuar nga z.Naim Maloku bashkë me dy anëtarët e tjerë z.Bojan Stojanivić dhe zn.Melihate Termkolli. Fjalën ja japë z.Naim Maloku për ti paraqitur propozimet.

Naim Maloku tha, ne si grup referues nga Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, e kemi shqyrtuar këtë ligj bashkë me një grup referues nga Komisioni për Media, Shërbime Publike dhe Administratë, këtë grup të përbashkët e kam kryesuar unë. Ne kemi hartuar nëntë propozim-amendamente, të cilat do ti prezantojmë në komision për shqyrtim dhe miratim.

Pas leximit të propozim amendamenteve komisioni miratoi të gjitha amendamentet e propozuara.

Kryesuesi konstatoi, se raporti me këto amendamente të miratuara për Ligjin për gjendjen civile, të procedohet për miratim në seancë plenare.

5. Të ndryshme

Kryesuesi tha, në mbledhjen e kaluar të komisionit ne kemi pasur në takim Komandantin e TMK-së, Gjeneral Sylejman Selimi, i cili ka raportuar për procesin e shpërbërjes së TMK-së. Nga ai debat ne kemi hartuar një raport me rekomandime, të cilat ju i keni përpara. Këto rekomandime kanë të bëjnë me atë që pjesëtarët e TMK-së, të informohen sa më shumë për këtë proces, sepse nuk janë sa duhet të informuar. Pastaj asnjë pjesëtar i të mos i ndërpritet paga deri në risistemimin e tyre, gjithashtu komisioni përkrahu idenë për themelimin e një grupi ndërministror, për të ndihmuar procesin e ri-sistemimit për pjesëtarët e TMK-së.

Emrush Xhemajli tha, këto rekomandime janë me kohë, sepse ka nevojë për më shumë informacion për pjesëtarët e TMK-së.

Naim Maloku the, se unë i përkrah këto rekomandime që kanë dal nga takimi me Komandantin e TMK-së. Po ashtu ai theksoi se kryetari i komisionit duhet të këtë komunikim me grupin ndërministror. Dhe ai grup duhet të vijë në komision të raportojë për punën e vet pasi komisioni ynë ka obligim ligjor të mbikëqyrë këtë proces.

Shkumbin Demaliaj tha, ne kemi miratuar ligjin për shpërbërjen e TMK-së, dhe mendoj se ka institucione tjetra si zyra e koordinatorit të TMK-së që duhet të merret me këto çështje. Unë pra abstenoj sa i përket miratimit të këtyre rekomandimeve.

Zafir Berisha tha, unë votoj kundër sepse rekomandimet e komisionit nuk po merren parasysh. Në si komision nuk e dimë nga kush përbëhet grupi ndërministror.

Eqrem Kryeziu tha, se unë jam për këto rekomandime dhe kam një riformulim tjetër të rekomandimi ku flitet për pagën e pjesëtarëve të TMK-së. Pra propozoj që aty ku thuhet ndërpritet paga të jetë që mos ti ndërpritet përkrahja financiare.

Kryesuesi, në përfundim të diskutimeve për këto rekomandime konstatoi se, këto rekomandime u miratuan dhe ato ti dërgohen Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe institucioneve tjera relevante.

Në kuadër të kësaj pike kryesuesi njoftoi, që në mbledhjen e kaluar ne jemi pajtuar për një projekt-propozim, që OSBE-ja në bashkëpunim me OJQ-në KIPRED, ka propozuar një projekt të përbashkët me komisionin, që përfshinë disa vizita të komisionit në teren me popullatë të përzier. Unë propozoj ti bëjmë tri ekipe që do ti realizojnë vizitat. Kryesues të këtyre ekipeve caktojë këta deputet: Shkumbin Demalija, Naim Maloku dhe Eqrem Kryeziu. Këta do ti kordinojnë punët me organizatorin, për datat dhe vendet e vizitave.

Kryesuesi në fund të mbledhjes njoftoi, se në kuadër të bashkëpunimit të komisionit me institucionet ndërkombëtare, është një ide që të organizohet një takim një ditor në të cilin do të diskutohej për Dëgjimin Publik, si një prej formave të mbikëqyrjes parlamentare ndaj ekzekutivit. Po ashtu me datë 24 deri me 25 nëntor, pritët të organizohet nga OSBE-ja dhe DCAF-i, një seminar regional në Shkup, për mbikëqyrjen parlamentare ndaj sektorit të sigurisë.

Mbledhja përfundoi në orën 12.30

Rrustem Mustafa
Kryetar i Komisionit

Përgatiti:
Njësia mbështetëse e komisionit

